



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.3/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesve “[L.P]” dhe “[S.B]”, që të dy nga prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson [A.T] – Avokat nga Prishtina, kundër kundërshtarëve të sigurimit: “[P...]” L.L.C, me seli në Prishtinë, “[A.S]” dhe “[V.Q]”, që të dy nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson [B.K] dhe [H.SH], që të dy Avokat nga Prishtina, duke vendosur sipas ankesës së propozuesve të sigurimit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.508/20, të datës 03.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.01.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET ankesa e propozuesve të sigurimit, “[L.P]” dhe “[S.B]”, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.508/20, të datës 03.12.2020 **PRISHET**, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesve të masës së sigurimit “[L.P]” dhe “[S.B]”, të parashtruar kundër kundërshtarëve të sigurimit “[P...]” L.L.C, me seli në Prishtinë, “[A.S]” dhe “[V.Q]”, që të dy nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar që t’iu ndalohet kundërshtarëve të sigurimit që pasurinë e shoqërisë “[P...]” L.L.C, ta tjetërsojnë, ta fshehin apo ngarkojnë apo në çfarëdo mënyre të vështirësojnë kërkesën e propozuesve të sigurimit, si dhe t’iu ndalohet kundërshtarëve të sigurimit kryerja e transaksioneve bankare në të gjitha llogaritë bankare të Shoqërisë “[P...]” L.L.C., deri në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike kontestimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë propozuesit e sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta anuloj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë për caktimin e masës së sigurimit dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje apo të njëjtin ta ndryshojë dhe ta aprovojë propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurisë.

Përgjigje në ankesë ka bërë përfaqësuesi i kundërshtarëve të masës së sigurisë, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta refuzoj ankesën e kundërshtarit të sigurimit ashtu që të mbetet në fuqi aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktvendimit të atakuar dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 194 në lidhje me nenin 208 të LPK, Gjykata e Apelit ka gjetur :

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesit e masës së sigurimit [L.P] dhe [S.B], me datë 14.12.2020 kanë paraqitur pranë kësaj gjykate padi për kompensim dëmi për shkak të mospagesës së dividendës me propozim për caktimin e masës së sigurisë, ndaj kundërshtarëve të sigurimit me pretendim se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit do të vështirësohej realizimi i kërkesës së tyre të parashtruar me padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me aktvendimin e atakuar, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e palës propozuese për caktimin e masës së sigurisë.

Në këtë gjendje të çështjes juridike, Gjykata e Apelit ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika n) e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se aktvendimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm ndërsa në arsyetim nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë është referuar ne dispozitat e Nenit 297 par. 1 pika a) dhe b) dhe Nenit 297 par. 2 të LPK-së, por nuk është dhënë asnjë fakt i vërtetuar dhe asnjë arsye pse gjykata ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës siguroese. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se propozuesit nuk e kanë bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës pasi kishte konstatuar se sipas të dhënave të ARBK-së, lidhur me historikun e pronarëve të shoqërinë në fjalë, propozuesit e sigurimit nuk kanë qenë bartës të të drejtave pronësore në shoqëri, asnjëherë nga themelimi i shoqërisë. Ky konstatim i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim të plotë me provën e cila gjendet në shkresa të lëndës "Informata mbi biznesin" të ARBK-së, të datës 07.09.2019, ku ne faqen 4/6 vërtetohet qartë se propozuesit [L.P] dhe [S.B] janë bashkëpronarë ne shoqërinë "[P...]" L.L.C.

Sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se: "Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fsheljen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesit duhet ta bëjnë të besueshme ekzistimin e kërkesës respektivisht të dëshmojnë se në mënyrë të kundërligjshme janë privuar nga të drejtat e tyre si aksionar ne "[P...]" L.L.C. dhe se ata nuk ka mundur t'i gëzojë të drejtat të cilat gjatë periudhës kontestuese të cilat i kanë gëzuar kundërshtaret e sigurimit, si dhe ta bëjë të besueshme se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar nuk janë dhënë fare arsye për këto fakte vendimtare por gjykata është fokusuar në bazueshmërinë e kërkesëpadisë dhe ka dhënë konstatime të paqëndrueshme lidhur me objektin e kërkesëpadisë të cilat mund të jenë objekt shqyrtimi në seancën e shqyrtimit kryesor e jo në seancën dëgjimore për vlerësimin e masës së sigurimit dhe me këtë ka paragjykuar çështjen kryesore, çka bie në kundërshtim me Nenin 300 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *"masat e sigurimit nga ky nen nuk guxojnë në tërësi ta përfshijnë kërkesën që sigurohet me anë të tyre"*.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitohet të gjitha të metat të cekura më lartë, t'i vërtetohet faktet relevante të sipërpërmendura, t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme për të vlerësuar nëse janë plotësuar kushtet nga Neni 297 par.1 i LPK-së, ashtu që pastaj, lidhur me masën e propozuar të vendos drejt dhe sipas Ligjit.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ae.nr.3/2021, me dt.18.01.2021

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Mahir Tutull, dv.

